



Udhëzues

Bashkëshoqërues i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Grupit Lokal të Veprimit (GLV) të Shqipërisë dhe Grupit Lokal të Veprimit (GLV) të Malit të Zi lidhur me bashkëpunimin mbi mbrojtjen e mjedisit, turizmin, rikrijimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në territoret e dy komuniteteve në secilën anë të kufirit ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Malit të Zi në Malet e Bjeshkëve të Namuna/Prokletije.





Përcaktimi i njësisve gjeografike në këtë publikim dhe prezantimi i materialit, nuk nënkupton shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e IUCN, SNV, WWF apo të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës, në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori ose zone, apo të autoriteteve të tyre dhe në lidhje me përcaktimin e kufijve shtetëror të tyre.

Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk prezantojnë domosdoshmërisht ato të IUCN, SNV, WWF apo të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës.

IUCN dhe organizatat e tjera partnere nuk marrin për sipër gabimet e bëra gjatë përkthimit nga versioni origjinal anglisht në gjuhën shqipe apo atë malazeze.

Ky publikim u mundësua dhe nga financimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës.

Publikuar nga: IUCN, Gland, Zvicër dhe Beograd, Serbi.

E drejta e autorit: © 2012 International Union for Conservation of Nature and Natural Resources.

Riprodhimi i këtij publikimi për qëllime edukative apo të tjera jo-fitimprurëse është i autorizuar pa një leje paraprake me shkrim nga zotëruesi i të drejtës së autorit dhe njihet plotësisht nga burimi.

Riprodhimi i këtij publikimi për rishitje ose qëllime të tjera komerciale është i ndaluar, pa siguruar më parë lejen me shkrim nga zotëruesi i të drejtës së autorit.

Autor: Michael R. Appleton

Bashkëpunëtorë: Alois Lang, Tomasz Pezold

Dizenjuar nga: Imre Sebestyén jr. / UNITgraphics.com

Foto: Tomasz Pezold

Prodhuar nga: Zyra e Programit të IUCN për Evropën Jug- Lindore.

Printuar nga: Optimus, Novi Sad

I disponueshëm: IUCN Programme Office for South-Eastern Europe
Dr Ivana Ribara 91
11070 Belgrade, Serbia
see@iucn.org
Tel +381 11 2272 411
Fax +381 11 2272 531
www.iucn.org/publications

Hyrje

Këto udhëzime synojnë të plotësojnë dhe shpjegojnë nenet e Memorandimit të Mirëkuptimit (MM), duke sygjerruar mënyrën se si Grupet Lokale të Veprimit mund ti zbatojnë udhëzimet në vendet respektive, dhe mënyrën se si ato mund të bashkëpunojnë për zbatimin e udhëzimeve përgjatë Zonës Ndërkufitare.

Ky MM nuk është një MM tipik i zonave ndërkufitare, pasi ai është përgatitur nga Grupet Lokale të Veprimit dhe jo nga autoritetet zyrtare kombëtare apo rajonale. GLV-të nuk kanë fuqi statutore ndaj nuk mund të kërkojnë ndërmarrjen e ndonjë veprimi të vecantë (megjithëse disa prej organizatave anëtare të GLV-ve mund të kenë një fuqi të tillë). Për më tepër MM nuk mund të jetë një detyrim ligjor. Në përputhje me këtë, MM është përgatitur në mënyrë të tillë që nenet e tij të mos jenë detyrues; GLV-të për të arritur qëllimet e tyre duhet të mbështeten gjerësisht në zhvillimin e fushatave, rritjen e besimit, lobimet, shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimin dhe zhvillimin e konsensusit. Shpresohet që MM do të sigurojë kuadrin e duhur për ndërmarrjen e veprimeve të tilla. Megjithëse synohet të krijohet një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet GLV-ve, ekzistojnë kufizime të pashmangshme lidhur me logjistikën, burimet e pranishme dhe ndryshimet në gjuhën e komunikimit. Ndaj Udhëzimet japin sygjerrime mbi veprimet që GLV-të mund të bëjnë më vehte në vendet e tyre

respektive si dhe sygjerrimet për aktivitetet në të cilat ato mund të bashkëpunojnë në mënyrë të dobishme dhe produktive.

MM dhe shënimet e udhëzimeve janë mbështetur në disa burime, e në vecanti:

- Rezultatet dhe konkluzionet e workshopit të përbashkët të mbajtur në Shkodër, Shqipëri në datat 12-13 Shtator 2011, që u ndoq nga anëtarët e të dy GLV-ve, përfaqësues të organizatave të tjera të interesuara si dhe ekspertë ndërkombëtarë.
- Udhëzimi mbi zonat e mbrojtura ndërkufitare dhe bashkëpunimi i realizuar ndër të tjera ndërmjet IUCN dhe Bankës Botërore (Shih listën e referencës)
- Eksperienca personale e autorit, ekspertëve dhe kolegëve të tjerë.

Ky MB u firmos në 8 Maj 2012 në kuadër të zbatimit të projektit "Mjedisi për Njerezit e Harkut Dinarik" nga IUCN (Unioni Nderkombetar për Ruajtjen e Natyrës), WWF Mediterranean Program dhe SNV (Organizata Hollandeze për Zhvillim), financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandes

Sfondi i përgjithshëm

Objektivat e Memorandumit të Mirëkuptimit (MM)

Palët marrin pjesë në këtë MM me objektivat e mëposhtëme:

1. Të fuqizojnë bashkëpunimin ndërkufitar lidhur me mbrojtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural, vecanërisht në ofrimin e turizmit ndërkufitar si dhe aktiviteteve shoqëruese të tij (p.sh. shplodhje, ofrim shërbimesh, marketing i prodhimeve lokale).
2. Të mbështesin fuqizimin e Palëve për të siguruar një nivel të lartë pjesëmarrje, transparence dhe ndarje të barabartë përfitimesh në vendimet e marra mbi mbrojtjen, menaxhimin dhe zhvillimin e zonës ndërkufitare.
3. Të fuqizohet kapaciteti i Palëve për të mbrojtur dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme mjedisin si dhe për të ruajtur kulturën dhe traditat e tyre.
4. Të sigurohen bazat për zhvillim bashkëpunues të komunitetit – turizmi rural bazuar në zonën ndërkufitare do të mbështesë jetesën dhe ekonominë lokale.
5. Të sigurohet mbështetje si dhe bazat organizative për një bashkëpunim në rritje midis Palëve.

Besimet dhe vlerat e përbashkëta

Palët marrin pjesë në këtë MM duke njohur besimet dhe vlerat e më poshtëme:

- Ndajnë të njëjtin angazhim për të ruajtur paqen, miqësinë dhe bashkëpunimin me përfitim të ndërsjellë midis Palëve dhe komuniteteve të tyre lokale.
- Palët janë të ndërgjegjshme se ndajnë të njëjtin mjedis dhe trashëgimi natyrore në të dy anët e kufirit ndërkombëtar dhe se “natyra nuk njih kufij”.
- Ndajnë të njëjtin angazhim për të ruajtur kulturën dhe traditat lokale; si ato të ruajtura më vehte ashtu edhe ato të ruajtura bashkarisht.

- Ndajnë tradita të forta në ofrimin e ngrohtësisë dhe mikëpritjes për vizitorët dhe miqtë, gjë që e bën zonën vecanërisht tërheqëse dhe mikëpritëse për turistët.
- Ndajnë të njëjtin angazhim për mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit, bukurive natyrore të zones ndërkufitare, për mirëqenien e natyrës, kulturës dhe atë të njeriut.
- Ndajnë të njëjtin angazhim për të krijuar një ekonomi lokale të lulëzuar dhe të qëndrueshme që mbështet komunitetet dhe u krijon kushte të përshtatshme njerëzve për të qëndruar në zonë.
- Ndajnë të njëjtin besim se përmes një menaxhimi të mirë natyra mund të ofrojë përfitime për njerëzit përmes përdorimit të qëndrueshëm, grumbullimit të produkteve dhe turizmit.

Shqetësimet e përbashkëta

Gjithashtu Palët marrin pjesë në këtë MM duke njohur shqetësimet e përbashkëta si më poshtë:

- Kostot e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre për konservimin e natyrës nuk duhet të tejkalojnë përfitimet që sigurohen prej këtij konservimi.
- Përfitimet që krijohen nga turizmi dhe zhvillimi në dhe përreth komuniteteve duhet në radhë të parë të orientohen tek këto komunitete dhe të ndahen në mënyrë të drejtë dhe transparente ndërmjet tyre.
- Krijimi i zonave të mbrojtura ligjërisht dhe projektet ndërkufitare nuk duhet të planifikohen dhe të realizohen pa konsultimin e duhur me komunitetet lokale.
- Kufizimet në kalimin e kufirit dhe në zhvillimin e aktiviteteve ndërkufitare do të kufizojnë mundësitë për bashkëpunim si dhe mundësinë për turizmin e qëndrueshëm në zonë.

Komente dhe Udhëzime mbi Nenet e MM

NENI 1. MBROJTJA E NATYRES DHE MJEDISIT DHE PERDORIMI I QENDRUESHEM

Palët janë dakort të:

1 Punojnë brënda komuniteteve të tyre dhe të bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse për të ulur prerjet e jashtëligjshme dhe parandaluar ato dhe/ose shfrytëzimin e paqëndrueshëm të natyrës dhe burimeve natyrore.

Komente dhe udhëzime

GLV mund të luajë një rol kryesor në parandalimin e përdorimit të jashtëligjshëm dhe të paqëndrueshëm të burimeve në zonë. Kjo mund të arrihet përmes disa rrugëve si:

- Fillimi i një fushate të përgjithëshme ndërgjegjësimi lidhur me vlerën e burimeve natyrore, pasojat e degradimit të tyre si dhe nevojën për mbrojtje dhe qëndrueshmëri.
- Krijimi i “grupeve të përdoruesve” të burimeve natyrore (p.sh. përdoruesit e kullotave, prodhuesit e mjaltit, mbledhësit e boronicave) që mund të diskutojnë dhe zgjidhin problemet përmes dialogut dhe bashkëpunimit. Në disa vende zhvillohen takime të rregullta (të paktën vjetore) ndërmjet autoriteteve të zonave të mbrojtura dhe grupeve të përdoruesve.
- Punësimi i banorëve lokal si roje dhe kujdestarë të zonave të mbrojtura. Kjo krijon mundësi alternative punësimi për ata që do të përbënin një kontigjent për tu përfshirë në aktivitete të jashtëligjshme.
- Bashkëpunim nga afër me administruesit e zonave të mbrojtura për të arritur bashkëpunimin në parandalimin e aktiviteteve ilegale.

Masa të vecanta për bashkëpunim ndërkufitar

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar mund të ndërmerren një seri veprimesh specifike:

- Lehtësim për autoritetet e zonave të mbrojtura në shkëmbimin e informacionit lidhur me problemet e zonave ndërkufitare. Kjo mund të realizohet për shembull përmes identifikimit të personave të kontaktit, shkëmbimit të numrave të telefonave si dhe krijimit të një vale të përbashkët mbi sistemet e radios që lejon dhe lehtëson komunikimin ndërmjet zyrtarëve të terrenit.
- Edukimi i rojeve kufitare lidhur me krimin mjedisor ndërkufitar si dhe mbështetja e tyre për të inkurajuar bashkëpunimin në parandalimin e shkeljeve dhe fuqizimin e ligjeve kombëtare në përputhje me çështjen. Një përjasje e tillë po zbatohet nga një projekt i PNUD që vepron në zonën kufitare ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës. Ndaj, për të mësuar më shumë rreth këtij projekti do të ishte me vlerë të kontaktohen punonjësit e PNUD në Shkup.
- Shkëmbimi i njohurive dhe informacionit ndërmjet GLV-ve dhe komuniteteve që ato përfaqësojnë lidhur me problemet dhe zgjidhjet e tyre.

2 T’ju kërkohet autoriteteve përgjegjëse që të sigurojnë një shkallë të lartë pjesëmarrje të të interesuarve si dhe transparencë në planifikimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura duke krijuar njësitë zyrtare të konsulencës si dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së zonave të mbrojtura që ekzistojnë sot apo atyre që do të përcaktohen në të ardhmen brënda zonave ndërkufitare.

Komente dhe udhëzime

Zonat e mbrojtura të krijuara në zonën ndërkufitare duhet të marrin në konsideratë pikëpamjet, aspiratat dhe jetesën e komuniteteve lokale, ato duhet të përcaktohen dhe menaxhohen duke vënë theksin fuqimisht në pjesëmarrjen lokale. Pjesëmarrja është një mekanizëm i fuqishëm dhe i rëndësishëm për menaxhuesit e zonave të mbrojtura, bazuar në krijimin e besimit që të interesuarit të jenë të informuar, të përfshirë, të shprehin forcën e tyre, të bëjnë përzgjedhjet e duhura dhe të ndihmojnë menaxhuesit dhe vendim marrësit të bëjnë gjithashtu përzgjedhjet më të mira.

GLV-të duhet të marrin masat e duhura për të siguruar:

- Identifikimin e personave lokalë të interesuar, të informuar dhe të konsultuar gjatë procesit të krijimit, planifikimit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura.
- Shkëmbimin e informacionit në zonat e mbrojtura në mënyrë të hapur me personat lokal të interesuar.
- Krijimin e proceseve konsultuese zyrtare për të interesuarit në të gjithë zonat e mbrojtura (për shëmbull në formën e Këshillave Konsultativë). Procese të tilla duhet tu krijojnë mundësi të interesuarve të takohen me administruesit e zonave të mbrojtura mbi baza të rregullta, me kusht që administratorët të marrin në konsideratë pikëpamjet e të interesuarve.
- Mundësinë e krijimit të Bordeve Menaxhuese me fuqi vendim marrëse për zonat e mbrojtura apo për pjesë të caktuara të zonave të mbrojtura (p.sh. zonat buferike dhe zonat me përdorim të qëndrueshëm). Nëse krijohen Borde të tillë Menaxhimi, GLV-të duhet të garantojnë që këto borde të përfshijnë përfaqësues kompetent dhe në numër të mjaftueshëm.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të duhet të shkëmbejnë informacion dhe eksperiencë lidhur me zonat e mbrojtura në të dy anët e kufirit dhe të inkurajojnë zonat e mbrojtura të krijuara në njërin anë të kufirit të bashkëpunojnë dhe të krijojnë partneritete me zonat e mbrojtura në anën

tjetër të kufirit. Nëse merret një vendim për të krijuar zyrtarisht një Zonë të Mbrojtur ndërkufitare, GLV-të duhet të garantojnë një përfaqsim të përshtatshëm në çdo grup të përbashkët këshillues apo administrativ që është krijuar.

3 Mbështetje autoriteteve përgjegjëse për të zhvilluar marrëveshje për përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në sipërfaqe të vecanta të cdo zone të mbrojtur ekzistuese ose atyre që do të përcaktohen në të ardhmen. Përdorime të tilla mund të përfshijnë kullotjen si dhe mbledhjen e bimëve të egra dhe frutave të pyllit.

Komente dhe udhëzime

Përfaqësues nga të dy komunitetet kanë shprehur shqetësimin se krijimi i zonave të mbrojtura do të kufizojë aktivitetet e tyre tradicionale, veçanërisht kullotjen dhe grumbullimin e boronicave. Përqasjet moderne për menaxhimin e zonave të mbrojtura pranojnë se përdorimi i qëndrueshëm mund të jetë një aktivitet i ligjshëm dhe përfitues në zonat e mbrojtura duke patur parasysh se këto aktivitete zhvillohen në zona për të cilat është rënë dakort më parë dhe të cilat janë objekt i zbatimit të rregulloreve që sigurojnë qëndrueshmëri. Në disa raste rregullore të tilla përgatiten gjithashtu për të favorizuar përdoruesit lokalë si dhe për të mbrojtur zonën nga demtimi masiv për qëllime komerciale nga interesa që ndodhen jashtë zonës.

GLV-të duhet të inkurajojnë dhe nëse është e nevojshme të llojnë me autoritetet përgjegjëse për tu siguruar se shtrirja dhe zhvillimi i rregulloreve të zonave të mbrojtura në të dy anët e kufirit përfshin:

- Përpilimin mbi bazë komuniteti të hartave të zones që është objekt i përdorimit tradicional nga banorët lokal.
- Grumbullimi i informacionit mbi të drejtat e përdoruesve, produktet që përfitohen, sasi të dhe tregjet.
- Rënie dakort mbi zonat me përdorim të

qëndrueshëm, dhe rregulloret, bazuar në një kompromis nëse kërkohet ndërmjet nevojave njerëzore dhe prioriteteve të biodiversitetit.

- Rënie dakort mbi mekanizmat për monitorimin dhe krijimi i kompetencës për rregulloret e rëna dakort.
- Krijimi i “grupeve të përdoruesve” për produkte apo aktivitete të caktuara të tillë si boronicat, prodhimi i mjaltit ose kullotja.

Masa të vecanta për bashkëpunim ndërkufitar

Në zonat ndërkufitare mund të jetë dobi prurëse që të garantohet se rregulloret e rëna dakort janë të njëjta në secilën anë të kufirit dhe mundësojnë shkëmbimin e ideve ndërmjet të dy komuniteteve dhe autoriteteve të zonave të mbrojtura. Komunitetet duhet të, por gjithashtu për të parandaluar vjeljet e jashtëligjshme në zonat kufitare, kullotjen dhe gjuetinë, të cilat janë burime të mundëshme për konflikt.

4 Inkurajimi i autoriteteve përgjegjëse në Shqipëri dhe Mal i Zi për të bashkëpunuar me qëllim që të harmonizohen kufijtë, zonat si dhe të realizohen rregjimet e duhura të menaxhimit në zonat e mbrojtura aktuale apo në ato që do të përcaktohen në të ardhmen në të dy anët e kufirit.

Komente dhe udhëzime

Zonat e mbrojtura në të dy anët e kufirit duhet të jenë në përputhje me zonimin. Në të kundërt krijimi i rregjimeve të përbashkëta, turizmi dhe përdorimi i qëndrueshëm do të jetë i vështirë. Bashkëpunimi i komunitetit mund të jetë i ndërlikuar dhe efektiviteti i konservimit në të dy zonat mund të dobësohet.

Masat e vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

Në mënyrë ideale zonat ndërkufitare të planifikuara bashkërisht mund të krijohen përmes një procesi të përbashkët që përfshin autoritetet përgjegjëse, GLV-të dhe të interesuar të tjerë të zonës.

5 Njohuritë dhe aftësitë që bartin komunitetet kontribuojnë në programet e kërkimit, të vëzhgimit, si dhe në monitorimin e natyrës dhe mjedisit.

Komente dhe udhëzime

Banorët lokal shpesh kanë një mori njohurish rreth një zone, relievit të saj, mjedisit, natyrës dhe kulturës, por njohuritë që janë në nivel lokal shpesh anashkalohen nga shkencëtarët dhe ekspertët gjatë kryerjes së vëzhgimeve dhe monitorimeve të zonave të mbrojtura. Përfshirja e banorëve lokal në vëzhgime apo studime të tilla është një mënyrë e shkëlqyer për të mundësuar pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të zonave të mbrojtura dhe të interesuarve lokal. GLV-të duhet të inkurajojnë dhe mundësojnë pjesëmarrje të tilla përmes përfshirjes së grupeve të shkollave dhe studentëve, përdoruesve të burimeve si dhe personave të tjerë që e njohin mirë zonën. Njohuritë tradicionale të të moshuarve janë vecanërisht të vlefshme dhe nëse nuk grumbullohen mund të humbasin një herë e përgjithnjë. Njohuri të tilla mund të përdoren gjithashtu në zhvillimin e programeve për turistët e zonës.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të mund të veprojnë si mekanizma të shkëmbimit të njohurive ndërmjet zonave kufitare, duke ju mundësuar kërkuesve dhe ekspertëve të përdorin informacion nga të dy vendet. Kjo mund të jetë vecanërisht e rëndësishme për studime të një numri të konsiderueshëm kafshësh, specieve migratore si dhe proceseve ekologjike në zonën ndërkufitare.

6 Ruajtja e një standarti të lartë pastërtie dhe higjienë në zonën ndërkufitare duke i kushtuar vëmendje të vecantë hedhjes së pa përgjegjësme të mbeturinave si dhe mbrojtjes së rrjedhave ujore.

Komente dhe udhëzime

Turistët ekologjikë dëshirojnë të kenë eksperiencën në një mjedis të pastër si dhe të shohin gjurmë të përkujdesjes njerëzore ndaj mjedisit. Sidoqoftë rritja e turizmit zakonisht sjell edhe një rritje të mbetjeve, shpesh kjo në një nivel që nuk mund të përmirësohet nga praktikatat dhe sistemet ekzistuese. Gjithashtu duhet mbajtur parasysh që problemi i mbetjeve nga njëra anë e kufirit ka ndikim në bizneset e anës tjetër të kufirit. GLV-të duhet të punojnë me autoritetet lokale dhe grupet e tjera për të ndihmuar që të sigurojnë që:

- Për komunitetin ekziston një sistem i duhur i grumbullimit të plehrave dhe depozitimit të tyre.
- Shtigjet dhe lehtësitë e tjera për turistët të mbahen pastër. Duhet të sigurohen vende të përshtatshme për depozitimin e plehrave, për

të mirëmbajtur shtigjet, veçanërisht zonat me vizitueshmëri të lartë. Vizitorët dhe ekskursionistët duhet të inkurajohen që ti marrin mbeturinat e tyre me vete dhe jo ti lënë ato në zonë pas largimit nga zona.

- Hotelet, restorantet dhe lehtësitë e tjera kanë sisteme të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve dhe ujrave të zeza. Rritja e përdorimit të tualeteve dhe ujit shpesh neglizhohet në planifikimin turistik dhe mund të cojnë në ndotje të rrjedhave ujore si dhe ujit të pijshëm. Hoteleve të reja, etj., ju kërkohet që të instalojnë sisteme të përshtatshme të menaxhimit të ujrave dhe jo të mbingarkojnë sistemet ekzistuese.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të mund të veprojnë si mekanizma të shkëmbimit të njohurive, eksperiencës dhe praktikave të mira në menaxhimin e mbetjeve në të dy anët e kufirit. Ato gjithashtu mund të inkurajojnë ndjesinë e krenarisë në komunitete për ruajtjen e një mjedisi të pastër, duke theksuar se suksesi i turizmit varet nga pastërtia në të dy anët e kufirit.



Foto © Ervin Kallë

NENI 2. ZHVILLIMI I MUNDËSIVE PËR TURIZEM DHE SHPLODHJE NË ZONAT NDËRKUFITARE

Palët bien dakort të:

1 Identifikojnë dhe krijojnë në Zonën Ndërkufitare një rrjet të shtigjeve dhe rrugëve me distanca të gjata, me gjatësi dhe vështirësi të ndryshme që mund të përdoren si brenda secilit vend ashtu edhe ndërmjet vendeve kufitare.

2 Zhvillimi dhe krijimi i një sistemi të përbashkët të përputhshëm për identifikimin e shtigjeve dhe shënjat e rrugës.

të populluara. Për shtigje më të gjatë shënja të tilla rrugësh mund të jenë të ndërthurura dhe në këtë rast preferohet një numër më i vogël tabelash.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

Është shumë e rëndësishme që shtigjet të koordinohen midis të dy vendeve në një rrjet të përputhshëm dhe plotësues. GLV mund të ndërmarrë një rol drejtues në organizimin e një koordinimi të tillë.

3 Përgatitja e një harte të përbashkët të shtigjeve që mund të përdoret në botime në të dy anët e kufirit sikurse dhe në botime të përbashkëta.

Komente dhe Udhëzime

Sistemi i shtigjeve duhet të krijohet që të plotesoje nevojat e një numri të madh madh përdoruesish, që nga grupet e familjeve që kërkojnë një ekskursion të shkurtër, e deri tek persona me eksperiencë në botën e egër që kërkojnë të ecin në distanca të gjata. Sistemi i shtigjeve të secilit vend duhet të dizajnohet për të vepruar në mënyrë të pa varur (p.sh. të mos varet nga kalimi i kufirit), por gjithashtu duhet të jetë i përputhshëm për të dy vendet, kështu që kur hapen mundësitë e kalimeve në kufi, të behen të disponueshme edhe rrugë të reja.

Shembulli i Sllovenisë dhe Italisë tregon se sistemet e shënimit të rrugëve nuk kanë nevojë të jenë domosdoshmërisht identike (mund të ketë norma të ndryshme kombëtare), por ato duhet të jenë në përputhje me njëra tjetrën dhe lehtësisht të kuptueshme.

Shenjat e rrugës duhet të bëhen në mënyrë shumë të rregullt dhe të qartë në shtigjet e shkurtra dhe

Komente dhe udhëzues

Kjo hartë duhet të prodhohet në të dyja gjuhët dhe në Anglisht (nëse është e mundur edhe në një gjuhë tjetër ndërkombëtare). Harta duhet të jetë e cilësisë së lartë dhe e një shkalle të përshtatshme si dhe të printohet në material rezistent në mënyrë që të përdoret nga ekskursionistët në terren. Për shtigjet e gjata kërkohet të përgatiten harta cilësore topografike. Gjithnjë e më shumë harta të tilla paraqesin edhe gjurmë GPS si dhe pikat e rrugës.

Një problem që lidhet me ofrimin e hartave të shtigjeve është se hartat mund të inkurajojnë ekskursionistët pa eksperiencë të ndërmarrin rrugëtime që janë shumë të vështira për ata. Harta duhet të përfshijë detaje të kodit të treguesit rrugor për vizitorët (shih Nenin 2(7), detaje të vështirësisë dhe përshtatshmërisë së secilit shteg si dhe këshilla të përgjithëshme për sigurinë dhe mbrojtjen. Sic është përmendur më parë shënjat e rrugëve duhet të bëhen në baza shumë më

të rregullta dhe të dukshme në shtigjet shkurtra dhe të populluara.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të duhet të garantojnë një bashkëpunim efektiv në përgatitjen e hartës.

4 Inkurajim i autoriteteve përgjegjëse në të dy vendet për të lejuar ndonjë modifikim të kontrolleve të kufirit që do të mund të lehtësonte lëvizjet ndërkufitare të vizitorëve si dhe guidave të tyre lokale.

Komente dhe udhëzime

Turizmi ndërkufitar kërkon lehtësira në kalimin e kufirit ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë. Për të mundësuar një gjë të tillë kërkohet të zbulohen një seri masash. Të tilla si:

- Një sistem rregjistrimi të vizitorëve që kalojnë kufirin, duke përfshirë transmetimin e detajeve të pasaportave të tyre tek autoritetet kufitare të të dy vendeve.
- Një kufi i hapur ndërmjet (por jo përtej) zonave fqinje, me pikat kufitare në kufijtë e zonave të mbrojtura. Një rregullim i tillë është arritur të realizohet në kufirin midis Gjeorgjisë dhe Azerbajxhanit.
- Kërkesa që ekskursionistët ndërkufitarë të raportojnë tek autoritetet kur ata kalojnë kufirin.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përgatitjen e një propozimi të përbashkët për shkëmbimet kufitare.

5 Inkurajimi nga autoritetet kombëtare, bizneset dhe individët për të zhvilluar një seri elementësh infrastrukturorë të përshtatshëm dizenuar për standarde të larta mjedisore që do të lehtësojnë zhvillimin e turizmit në Zonat Ndërkufitare. Një infrastrukturë e tillë mund të përfshijë rrugë, furnizimin me ujë, energji, etj., ofrimin e dhomave për fjetje si dhe elementëve të tjerë tërheqës për vizitorët.

Komente dhe udhëzime

Është e rëndësishme të mbajmë në konsideratë se ofrimi i mundësive për turistët në një zonë të vecantë nuk është element garantues për ardhjen e tyre. Ofrimi i lehtësirave dhe sigurimi i infrastrukturës bazë është e rëndësishme për t'ju mundësuar njerëzve që të mund të përdorin zonën pa vështirësi të mëdha. Autoritetet lokale dhe sektori privat duhet të inkurajohen për të bërë të mundur që të paktën në zonë të jetë e pranishme infrastruktura bazë; rrugë në kushte të mira, shenjat (tabelat) ofrimi i mjeteve të transportit, furnizimi me energji, trajtimi i ujrave të zeza dhe mbetjeve, furnizimi me ujë, etj.

Në disa vende fshatarët kanë zhvilluar "paketa" për turistët, sipas të cilave ata mund të realizojnë ekskursione nga njëri fshat në tjetrin me rezervime për fjetjen në cdo fshat dhe në disa raste kur bagazhet e tyre mund të transportohen nga një pikë qëndrimi në tjetrën. Është një tendencë në rritje për fshatarët që të përdorin apo të japin me qera gomerë ose kuaj, si dhe opsioni për të ofruar transportin e bagazheve të ekskursionistëve nga një shtepi pritese tek tjera.

Sidoqoftë është e rëndësishme që infrastruktura të mos jetë e tepruar apo e pa përshtatshme dhe të jetë e mirë dizenuar (shih Nenin 2(6) më poshtë).

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të mund të punojnë së bashku që të sigurojnë që infrastruktura e shërbimit të jetë në përputhje me zonën dhe në një shkallë të përshtatshme.

6 Të garantohet që dizenjimi, ndërtimi dhe pozicioni i infrastrukturës të jenë të këndëshme dhe të përshtatëshme për stilet lokale, traditat dhe mjedisin.

Komente dhe udhëzime

Pikat tërheqëse dhe të vecanta nga një zonë e caktuar mund të shkatërrohen shumë shpejt nga dizenjimet, ndërtimet dhe pozicionimet e pa përshtatëshme të ndërtimeve dhe infrastrukturës. Problemet më tipike përfshijnë:

- Ndërtesa të reja që nuk përputhen me dizenjimet dhe stilet lokale.
- Përdorimi i materialeve të ndërtimit që nuk janë tipike apo tradicionale të zonës.
- Vendndodhja e godinave me një ndikim të madh mbi peisazhin (për shembull ndërtime që dominojnë pamjen apo e zënë atë, ndërtime të vendosura fare pranë pikave të bukura e tërheqëse, vendeve që shfaqin interes apo atyre historikë).
- Ndërtimi i ndërtesave të reja aty ku ekziston mundësia e rindërtimit apo rinovimit të një ndërtese ekzistuese (për shembull qendra e vizitorëve apo e informimit të turistëve).
- Ndërtimi i rrugëve. Shpesh komunitetet lokale e shohin ndërtimin e rrugëve si një prioritet; rrugët krijojnë një përmirësim në lëvizje drejt tregjeve dhe shërbimeve si dhe lehtësojnë lëvizjen e turistëve në zonë. Sidoqoftë, nga ana tjetër rrugët çojnë dhe në një rëndim të trafikut, ndotje si dhe në ndikime negative mbi terrenin. Ato duhet të planifikohen dhe gjurmët e tyre të vendosen në mënyrë të kujdesshme.
- Shenjat e pa qëndrueshme, jo tërheqëse dhe të dizenuara keq sikurse dhe përdorimi i një numri të madh shenjash mund të ngatërrojnë vizitorët si dhe të kenë një ndikim estetik negativ.

GLV-te duhet të punojnë së bashku me autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe urbanizimin lokal me qëllim që të sigurojnë standarte të larta dizenjimi, si dhe të inkurajojnë anëtarët e tyre që të realizojnë ndërtime të këndëshme. Kjo nuk do të thotë që njerëzit nuk duhet të kenë banesa dhe paisje moderne; pasi ekziston mundësia që të realizohen ndërtime të stilit tradicional, me material tradicional duke garantuar një standart të mirë konstruksioni, izolimi dhe ndërtimi.

Disa zona të mbrojtura kanë përgatitur manuale të udhëzuesve të dizenjimit për të gjitha strukturat, shenjat dhe materialet me qëllim që të sigurohet një pamje e qëndrueshme dhe tërheqëse. Në përgatitjen e këtij manuali, GLV-të mund të punojnë me autoritetet përgjegjëse për planifikimin, infrastrukturën dhe urbanistikën.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të duhet të bashkëpunojnë për të ruajtur terrenin dhe vlerat estetike të të gjithë zonës ndërkufitare, duke ditur se ndikimet negative nga njëra anë e kufirit do të kenë ndikim në pamjen e të gjithë zonës. GLV-të mund të punojnë së bashku në një projekt për të zhvilluar një sistem unik të shenjave për Zonën Ndërkufitare.

7 Zhvillimi i një kodi të përbashkët drejtues për përdoruesit e Zonave Ndërkufitare për shplodhje që përfshin elementë të lidhur me sjelljen, sigurinë, marrjen në konsideratë të elementëve mjedisorë si dhe ndjeshmërinë kulturore.

Komente dhe udhëzime

Kodet drejtues janë të rëndësishëm dhe duhet të përdoren gjerësisht në të gjitha botimet, guidat e ekskursioneve, tabelat e shenjat, etj. Përqasja moderne është krijimi i kodeve drejtues që përfshijnë shumë mesazhe pozitive të cilët inkurajojnë një sjellje korrekte, se sa thjeshtë ofrimi i një liste me aktivitetet e ndaluara. Kodet drejtues nëse është e nevojshme duhet të përfshijnë elementë të lidhur me ndjeshmërinë kulturore dhe atë mjedisore.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

Zhvillimi i një kodi të përbashkët drejtues (me disa ndryshime në nivel kombëtar nëse kjo është e nevojshme) do të jetë një çështje e mirë për tu trajtuar në një workshop të përbashkët nga të dy GLV-të.

NENI 3. OFRIMI I SHËRBIMEVE TURISTIKE NË CILËSI TË LARTË

Palët bien dakort të:

1 Bëjnë përpjekje për të siguruar një nivel të lartë shërbimi për vizitorët në përputhje me normat dhe kërkesat ligjore në fushën e turizmit dhe shpłodhjes, ndërkohë që ruhet karakteri lokal i dallueshëm si dhe ruhen tradita e mikpritjes dhe miqësisë me vizitorët.

2 Trajtohen ofruesit lokal të shërbimeve që të zhvillohen dhe të përplotësojnë standartet e kërkuara të shërbimit.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkuftar

Ekziston mundësia që standartet e kërkuara të mund të jenë të ndryshme në të dy anët e kufirit dhe që të dy GLV-të mund të dëshirojnë të zhvillojnë secili standartet e veta për ti përdorur në të gjithë Zonën Ndërkuftare. Kjo çështje mund të jetë subjekt i një workshopi të përbashkët ose një takimi të grupit të punës.

3 Përpjekje për një shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga turizmi dhe shpłodhja ndërmjet komuniteteve. Kjo shpërndarje do të marrë parasysh ofrimin e fjetjes dhe ushqimit, ofrimin e shërbimeve turistike si dhe përdorimin e produkteve lokale.

Komente dhe Udhëzime

Autoritetet Kombëtare të Turizmit zakonisht kanë një paketë ligjore normash dhe standartesh lidhur me fjetjen e vizitorëve (hotelet, bujtinat dhe mundësisht edhe zonat e kampingut), restorantet, kafenetë, etj. Bizneset lokale dhe individët mund të mos jenë të njohur me këto norma ndaj është një sfidë më vehte t'ju mundësohet atyre që të arrijnë standartet kombëtare si dhe standartet e pritshme nga turistët ndërkombëtarë.

GLV-të mund të luajë një rol të vecantë në publikimin dhe promovimin e standarteve të kërkuara, të trajnojnë ofruesit e shërbimeve për të arritur standartet si dhe të mbledhin fonde më qëllim që ata të arrijnë këto standarte. Përdorimi i granteve të vogla apo mikro kredive mund të jetë vecanërisht efektiv për një sipërmarrje të tillë.

Komente dhe udhëzime

Një nga rreziqet e zhvillimit të ekoturizmit me bazë komuniteti është "rrjedhja". Rrjedhja është pjesa e të ardhurave që krijohen mbi baza lokale nga turizmi por që nuk mbeten në zonë. Për shembull, rrjedhja ndodh kur një pronar hoteli blen të gjithë furnizimet e tij/saj në një qytet të largët, ose punëson punonjës që nuk janë banorë të komunitetit lokal, ose kur paratë e krijuara nga biznesi i shpenzon jashtë zonës lokale. Rrjedhja tenton të rritet kur bizneset zotërohen nga interesat jashtë zonës. Pa treguar kujdesjen e duhur, kur një zonë shndërrohet në një pikë tërheqëse popullore ndërmarrjet jashtë zonës mund të shohin një mundësi të mirë për biznes jo vetëm duke konkuruar me ndërmarrjet lokale por edhe duke i nxjerrë ato nga biznesi. Investitorët e jashtëm nuk janë domosdoshmërisht një e keqe, ata mund të sjellin investime dhe të krijojnë vende pune në zonë, por aktivitetet e tyre duhet të dizajnohen për të minimizuar rrjedhjen e të ardhurave.

Gjithashtu ekziston një rrezik që administruesit e zonave të mbrojtura do të zhvillojnë ndërmarrjet e tyre të turizmit të cilat mund të përfitojnë nga subvencionet e fshehta dhe të konkurojnë në mënyrë të pa ndershme me bizneset lokale. Për shembull menaxhuesit e një zone të mbrojtur mund të marrin një grant ndërkombëtar për të ndërtuar vende fjetje për vizitorët duke konkuruar me pronarët lokalë të bujtinave.

GLV-të mund të kenë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e bizneseve lokale si dhe në inkurajimin e investitorëve të jashtëm që të minimizojnë rrjedhjen. Ato mund të përfshihen në:

- Kërkimin dhe mobilizimin e mbështetjes për bizneset lokale, për shembull përmes këshillimit për zhvillim biznesi apo mikro kredive.
- Nxitjen e bizneseve jashtë komunitetit që të punësojnë popullatën lokale si dhe të kërkojnë shërbime e furnizime të mira brenda për brenda zonës.
- Bashkëpunimin me autoritetet e qeverisjes vendore dhe administratën e zonave të mbrojtura për të siguruar të drejta ekskluzive guide për udhërrëfyesit lokal të çertifikuar për turistë dhe zonat malore.
- Bashkëpunim me autoritetet e qeverisjes vendore për të siguruar mbrojtjen e bizneseve lokale, vecanërisht ndërmarrjet e vogla.
- Bashkëpunimin me administrues të zonave të mbrojtura për të siguruar bashkëpunimin e ndërmarrjeve turistike dhe pranimin e faktit se përfitimet nga turizmi duhet të ndahen me komunitetin lokal.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

Dy GLV-të mund të veprojnë si mekanizma për shkëmbim informacioni dhe ndarje eksperiencash në garantimin e ndarjes së përfitimeve dhe trajtimin e paanshëm të bizneseve të vogla lokale.

4 Ofrimi i informacionit të nevojshëm për vizitorët, në mënyrë të plotë, tërheqës dhe të vërtetë lidhur me traditat, zakonet, kulturën, historinë dhe natyrën e zonës ndërkufitare si dhe mbi standartet e sjelljes që pritet nga vizitorët.

Komente dhe udhëzime

Vizitorët kërkojnë informacion të besueshëm dhe të mirë prezantuar. GLV-të duhet të punojnë që të sigurohen që të gjithë ofruesit e shërbimeve të ofrojnë informacion të tillë. Aktivitetet mund të përfshijnë:

- Të sigurojnë se hotelet, guidat dhe operatorët e udhëtimeve kanë mjaftueshëm broshura, fletëpalosje dhe harta.
- Përgatitjen e “kërkuesve” për hotele dhe bujtina. Fletushka të cilat mund të mbushen me informacion rreth zonës, fletëpalosje, harta, etj.
- Trajnimin e ofruesve të shërbimeve për të ofruar informacion të rëndësishëm mbi zonën.
- Përdorimin e i shënjave dhe interpretimeve në vende të populluara
- Krijimin e pikave të informimit të vizitorëve.

Për bashkëpunimin ndërkufitar

Për zonën ndërkufitare do të jetë e rëndësishme që GLV-të të shkëmbejnë informacion dhe ofruesit e shërbimeve të jenë në gjendje të ofrojnë informacion lidhur me të dy anët e kufirit. GLV-të mund të punojnë për të siguruar një informacion të pranishëm dhe të saktë, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

GLV-të mundet gjithashtu të bashkëpunojnë në ofrimin e përkthimeve mbi materialet informuese të të dy vendeve.

5 Inkurajim dhe mbështetje aty ku është e mundur për prodhimet lokale të ushqimeve tradicionale dhe punimeve të dorës. Motivimi i ofruesve të shërbimeve që ti rezervojnë dhe ti vënë në dispozicion produkte të tilla me qëllim që të rritet niveli tërheqës i zones, të ruhen traditat lokale dhe të ndihmojnë në krijimin e një ekonomie të qëndrueshme.

Komente dhe udhëzime

Pjesë e eksperiencës së ekoturizmit mund të jetë edhe testimi nga vizitorët i produkteve tradicionale lokale. Kjo sjell një mbështetje të ekonomisë lokale, ulje të shpenzimeve, si dhe zvogëlon ndikimin mbi mjedis të mjeteve të transportit që përshkruajnë distanca të gjata. Prodhuesit lokalë duhet të inkurajohen dhe mbështeten për të arritur standardet e kërkuara të cilësisë sikurse ofruesit e shërbimeve lokale duhet të inkurajohen fuqimisht që të ofrojnë për aq sa është e mundur vetëm produkte lokale. Kjo praktikë mund të jetë pak më e shtrenjtë për vizitorët, por shumica e tyre do ta pranonin një gjë të tillë me kënaqësi. Komunitetet në mbarë botën bëjnë furnizime për shembull me lëngje frutash, çajra bimorë, mjaltë, fruta dhe perime lokale të sezonit, fruta të thata, reçel, verë dhe pije të tjera alkoolike, qumësht, djath, kos dhe produkte të tjera si mish, dhe peshk.

Kur vizitorët provojnë produkte të tilla, mund të kërkojnë edhe ti blejnë ato si “ushqime për dhurata” duke i marrë me vete kur largohen nga zona. Në mënyrë të ngjashme vizitorët ka gjasa që të preferojnë punime dore lokale të cilësisë së lartë të ofruara me çmime të ndryshme. Dyqanet duhet të inkurajohen të mbajnë rezerva të produkteve të tilla dhe të mbështesin ekonominë lokale, dhe jo të blejnë për shitje tek vizitorët suvenire të prodhuara masivisht edhe nëse ato mund të jenë me çmime të lira. Në shumë vende sipërmarrësit lokalë ose OJF-të kanë krijuar “punishtet e hapura” ku vizitorët mund të shohin artizanët lokalë duke punuar si dhe të mund të blejnë produktet e tyre.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndër kufitar

GLV-te mund të inkurajojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe ideve në promovimin e produkteve lokale; preferohet që të mos trajtohen produkte të përbashkëta, por të fokusohen në produkte tradicionale nga secili vend.

Duhet mbajtur parasysh se mund të ketë kufizime në lëvizjen e mishit, mjaltit dhe produkteve bujqësore përgjatë zonave ndërkufitare. Një gjë e tillë duhet të kontrollohet me kujdes.

6 Vendosja e standarteve të përbashkëta për trajnimin e guidave dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve në zonat ndërkufitare.

Komente dhe udhëzime

Guidat lokale duhet të trajnohen që të drejtojnë dhe të shoqërojnë ekskursionistët në zonat më të skajme malore. Trajnimi duhet të mbulojë njohuri mbi zonën, leximin e hartës dhe ndjekjen e saj, sigurinë dhe mbrojtjen si dhe aftësitë komunikuese (përfshirë edhe gjuhën nëse është e mundur).

GLV mund të jetë në gjendje të organizojë një material trajnimi si dhe të koordinojë një sistem të rregjistrimit dhe certifikimit të guidës.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të duhet të punojnë së bashku për të përgatitur materiale të përbashkëta dhe standarte për certifikim.

7 Bashkëpunim për të siguruar një standart të lartë për sigurinë dhe ruajtjen e vizitorëve si dhe zbatimin e procedurave dhe masave të duhura e të kuptueshme nga të gjithë për t'ju përgjigjur sic duhet aksidenteve dhe rasteve emergjente.

Komente dhe udhëzime

Mbrojtja dhe siguria e vizitorëve megjithëse e rëndësishme shpesh anashkalohet në zhvillimin e turizmit malor. Vizitorët ndërkombëtarë kanë pritshmëri më të larta ndaj vëmendjes kushtuar mbrojtjes dhe sigurisë së tyre se sa niveli i sigurisë dhe mbrojtjes me të cilin është mësuar popullata lokale. Në një masë të madhe vizitorët duhet të jenë përgjegjës për veprimet që bëjnë, por nga ana tjetër komunitetet duhet të marrin masa për:

- Identifikimin e rreziqeve të mundëshme për vizitorët e të gjithë llojeve.
- Identifikimin se çfarë mund të bëhet për të minimizuar rreziqe të tilla
- Sigurimin se vizitorët janë vënë në dijeni mbi rreziqet më të mëdha dhe masat që ata duhet të marrin si individë për të minimizuar rreziqe të tilla.
- Sigurimin e informacionit nëse të interesuarit lokalë janë në dijeni të rreziqeve, të marrin masa për ti minimizuar ato dhe të jenë të përgatitur të merren me rastet emergjente.

Masat e nevojshme mund të përfshijnë:

- Krijimin e një sistemi rregjistrimi të ekskursionistëve të zonës në mënyrë që të kuptohet nëse ata nuk arrijnë në destinacion në kohën e duhur. Kjo mund të realizohet përmes ofruesve të vendeve për fjetje apo përmes qendrave të vizitorëve apo zyrave të zonave të mbrojtura.
- Trajnimi i guidave malore dhe ofruesve të shërbimeve mbi ndihmën e shpejtë dhe teknikat e emergjencës si dhe furnizimi i tyre me pajisje të ndihmës së shpejtë.
- Garantimi i fjetjes dhe infrastruktures së sigurtë për vizitorët, sigurimi dhe minimizimi i rreziqeve nga, dhe prania e paisjeve për të trajtuar rastet emergjente.

- Krijimin e një shërbim-shpëtimi vullnetar në zonat malore.
- Diskutimin e procedurave të emergjencës me spitalet, rojet kufitare, shërbimet e zjarrfikjes, etj.
- Identifikimin e burimeve të ndihmës për evakuime në raste emergjencash krijuar nga fatkeqsitë (kompani helikopterësh, forcat e ushtrisë, etj.).
- Sigurimin e listës së numrave të kontaktit për raste emergjencash si dhe detaje se si mund të merret ndihma e kërkuar.

Masa të vecanta për bashkëpunim ndërkufitar

GLV-të mund të punojnë së bashku për të zhvilluar standarte dhe procedura të përbashkëta mbi sigurinë dhe mbrojtjen. Gjithashtu mund të ekzistojë një nevojë për të identifikuar porcedura dhe protokolle për evakuime nga njëra anë e kufirit në tjetrën në raste fatkeqësish (përmes kalimit të kufirit mund të jetë më e lehtë të arrish në zonën ku ndodh një fatkeqësi).

8 Përfshirje në konkurrencë të ndershme, të barabartë dhe bashkëpunuese midis ofruesve të shërbimeve brenda dhe ndërmjet vendeve, duke mbajtur parasysh se interesi i përbashkët është po aq i rëndësishëm sa edhe ai individual.

9 Bashkëpunim për të siguruar se të ardhurat e përftuara nga shërbimet e ofruara në një komunitet duhet të mbeten në atë komunitet. Një element i rëndësishëm i konkurrencës së ndershme, të barabartë dhe bashkëpunuese është se ofruesit e shërbimeve në njërin anë të kufirit duhet të shesin shërbime në anën tjetër të kufirit përmes ofruesve lokalë.

Komente dhe udhëzime (shih gjithashtu Nenin 3(3))

Konkurenca është pjesë e biznesit, por konkurenca e pandershme i nënvlerëson parimet e bashkëpunimit. Shumë nga bizneset të krijuara nga banorët lokalë, janë aq të dobët sa mund të dalin jashtë konkurrence nga ndërmarrjet e mëdha, me investime më të mëdha dhe një marketing më të mirë. GLV duhet të përpiqet që të inkurajojë një ekonomi të shërbimit turistik ndryshe, që krijon mundësi për bizneset e të gjithë madhësive, por që tregon kujdes të veçantë në mbrojtjen e bizneseve lokale të vogla dhe të specializuara. Masat më të përshtatshme mund të përfshijnë:

- Një promovim dhe marketing aktiv të bizneseve lokale nga autoritetet lokale dhe zonat e mbrojtura.
- Organizimi i tregjeve dhe panairove të veçanta për prodhuesit lokalë
- Mundësia e krijimit të një marketingu të përbashkët nga bizneset e vogla. Kjo përfshin grupe biznesesh përplotësues që ndajnë koston e reklamave dhe promovimeve të përbashkëta.
- Përdorimi i markës dhe logos së zonës ndërkufitare si një markë cilësie që zotërohet nga bizneset ekologjike me bazë lokale.

- Zbutje e taksave për bizneset ekologjike të vogla lokale.
- Mos lejimi i regjistrimit të bizneseve të mëdha që mund të sjellin konkurrencë të pa ndershme.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të mund të shkëmbejnë informacion dhe ide lidhur me përfaqesat për krijimin e konkurrencës së ndershme.

Mund të ekzistojë shqetësimi se një operator i mirë organizuar dhe me lidhje të shumta në njërin anë të kufirit mund të fillojë të tregëtojë dhe fitojë nga shërbimet që i ofron anës tjetër të kufirit. Kjo mund të rezultojë në rritje të tensionit ndërmjet komuniteteve dhe ofruesve të shërbimeve. GLV-të duhet të vendosin parime për operatorët ndërkufitarë që blejnë shërbime nga ana tjetër e kufirit dhe duhet të kenë një marrëveshje lidhur me guidat që drejtojnë grupet në kalimin e kufirit.



Foto: © Ervin Kalac

NENI 4. MARKETINGU DHE PROMOVIMI

Palët bien dakort të:

1 Punojnë së bashku për të zhvilluar dhe rënë dakort mbi një markë të përbashkët dhe imazh për zonën ndërkufitare, që do të përdoret krahas markave lokale dhe atyre kombëtare (nëse kjo kërkohet) në të gjithë marketimin në nivel lokal dhe kombëtar lidhur me Zonën Ndërkufitare.

Komente dhe udhëzime

Krijimi i markës dhe imazhit është një pjesë e rëndësishme e një zone rurale për turizëm si dhe për inkurajimin e ndërmarrjeve lokale. Një markë e përbashkët e zonës mund të këtë një shkallë të lartë përfitimesh si:

- Krijimi i një "imazhi" tërheqës për zonën dhe vlerat e saj unike.
- Mbështetje e marketimit të vazhdueshëm të zonës
- Krijimi i një "marke cilësie" për vizitorët si dhe mjeteve të marketingut për bizneset lokale përmes përdorimit të markës për njohjen e produkteve dhe shërbimeve të aprovuara për cilësinë e lartë dhe origjinën e tyre lokale.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

Zhvillimi i një marke dhe imazhi të përbashkët shihet si një nga rrugët më të mira për të inkurajuar mirëkuptimin dhe bashkëpunimin midis zonave kufitare. Të dy GLV-të duhet të organizojnë një seri workshopesh dhe konsulencë të përbashkëta, ose ndoshta një konkurs për të përgatitur markën e përbashkët, logon dhe imazhin. Ato duhet të bien dakort që të përdorin markën, logon dhe imazhin në të gjithë publicitetet dhe materialet e tyre promovuese si dhe ti inkurajojnë të interesuarit e tjerë për përdorimin e tyre.

GLV-të duhet të punojnë gjithashtu së bashku për të vendosur standarte të përbashkëta që të mund të lejojnë bizneset lokale të përdorin logon e zonës ndërkufitare.

2 Realizimi i fushatave dhe aktiviteteve të përbashkëta për marketing në zonën ndërkufitare.

3 Të punohet së bashku me autoritetet kombëtare të turizmit, agjensitë, operatorët turistikë dhe administratorët e zonave të mbrojtura për të bërë marketingun dhe promovuar mundësitë për turizëm në zonën ndërkufitare.

4 Krijimi i një faqe të përbashkët në rrjetet dhe/ose Facebook për zonën ndërkufitare.

5 Të garantohen botime të përbashkëta, dhe materialet e marketingut të ofrohen në të dy gjuhët kombëtare, në Anglisht dhe nëse është e mundur në një gjuhë tjetër ndërkombëtare.

Komente dhe udhëzime

Me qëllim tërheqjen e vizitorëve marketingu do të jëtë një element thelbësor. Ekzistojnë shumë zona malore në Europë që mund të përzgjidhen nga turistët

ndërkombëtarë; marketingu i këtyre zonave duhet të vërë në pah cilësitë e vecanta dhe duhet të dizajnohet me qëllim që të arrijë tek audienca e synuar.

GLV duhet të luajë një seri rolesh të rëndësishme në këtë rast, përfshirë këtu identifikimin e vlerave të vecanta të zonës, zhvillimin e publikimeve dhe materialeve promocionale si dhe përdorimin e mediave për të publikuar dhe promovuar zonën.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

GLV-të mund të organizojnë një workshop të përbashkët për të rënë dakort mbi cilësitë e vecanta të zonës si dhe strategjitë kryesore që do të përdoren për marketing. Ata mund të shkëmbejnë informacion

që të garantojnë se marketingu në nivel kombëtar për të dy vendet përputhet dhe është përplotësues. Gjithashtu ata duhet të garantojnë se materialet janë përkthyer në mënyrë korrekte në të dy gjuhët kombëtare, në Anglisht dhe nëse është e mundur në gjuhë të tjera ndërkombëtare.

Zhvillimi i një faqeje elektronike të përbashkët mund të jetë e vështirë sa i përket gjuhës dhe komunikimit të informacionit. Është e mundur të zhvillohet një portal i përbashkët që lejon përdorimin nga të dy anët e kufirit. Materiali në portal duhet të jetë gjithashtu së paku në Anglisht dhe është e preferueshme edhe në gjuhë të tjera ndërkombëtare. Përdorimi i Facebook po rritet gjithnjë e më shumë për qëllime marketingu dhe shpesh ai është më i shpejtë, më i lehtë dhe më i lirë për tu krijuar dhe mbajtur krahasuar me një faqe elektronike.



Foto © IUCN/Tomasz Pezold

NENI 5. KOMUNIKIMI, BASHKËPUNIMI DHE FINANCIMI

Palët bien dakort të

1 Krijonjë një komitet bashkëpunimi ndërkufitar që të takohet se paku dy herë në vit duke i alternuar vendet e takimit.

Komente dhe udhëzime/Masa të vecanta për bashkëpunimin Ndërkufitar

GLV-të duhet të krijojnë një komitet të përbashkët me funksionet e me poshtëme;

- Për të planifikuar dhe koordinuar aktivitetet për zbatimin e MM,
- Për të kërkuar financime dhe mbështetje,
- Për të shkëmbyer informacion dhe eksperiencë,
- Për të diskutuar problemet e përbashkëta,
- Për ti zgjidhur ato si dhe për të identifikuar dhe përdorur më së miri mundësitë
- Për të rishikuar progresin në zbatimin e MM.

Sygjerohet se ky Komitet duhet të takohet dy herë në vit; takime më të rregullta do të ishin ideale por kjo mund të jetë e vështirë për shkak të logjistikës dhe financimeve. Komiteti duhet të ketë përfaqësim të barabartë nga të dy GLV-të dhe anëtarët do të takohen duke i alternuar vendet ku takimet do të drejtohen nga një prej anëtarëve të vendit mikpritës. Një takim fillestar duhet të mbahet për të rënë dakort mbi anëtarësinë si dhe përcaktimin e Termave të Detajuara të Referencës.

2 Sigurimi i një shkëmbimi të vazhdueshëm dhe të hapur të informacionit me interes të përbashkët midis të dy Palëve.

Komente dhe udhëzime/Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

Krahas komitetit duhet të ketë dhe një mekanizëm që të sigurojë një shkëmbim të rregullt të informacionit si dhe GLV-të të punojnë së bashku në programe të përbashkëta të lidhura me MM. Kjo do të kërkojë që të dy GLV-të të zotërojnë pajisjet e duhura të komunikimit, ideale do të ishte komunikimi përmes kompjuterit si lidhjet e internetit që mundësojnë bisedime dhe Konferenca me kosto të ulët sic është Skype. GLV-të duhet të kërkojnë mbështetje nga donatorët për këtë qëllim, duke krijuar kështu një burim për komunitetin në të dy anët e kufirit.

Takimet e komitetit duhet të identifikojnë programet e përbashkëta të aktiviteteve si dhe personat përgjegjës për secilin GLV të cilët mund të punojnë më pas së bashku për zbatimin e programeve.

3 Ushrtimi i transparencës dhe mënyrës së hapur në realizimin e aktiviteteve si dhe inkurajimi dhe mundësimi i përfshirjes së të interesuarve të tjerë dhe grupeve të të interesuarve sa herë që të jetë e mundur.

Komente dhe udhëzime/Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

Duhet të mbahet parasysh se GLV-të mund të mos përfaqësojnë të gjithë të interesuarit. Nëse kërkohet ata duhet të zgjerojnë anëtarësinë e tyre, të identifikojnë dhe të përfshijnë të tjerë persona të interesuar dhe të garantojnë se janë ofruar mundësi për të gjithë të interesuarit që lidhen me këtë çështje (jo thjeshtë vetëm anëtarët e GLV).

4 Përmirësimi i komunikimit ndërmjet komuniteteve duke i inkurajuar individët që të mësojnë gjuhët e njëri tjetrit si dhe të realizojnë shkëmbime të rregullta ndërmjet komuniteteve.

Komente dhe udhëzime/ Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

Gjuha është një barrierë e konsiderueshme për të punuar së bashku. Individët zotërues të dy apo më shumë gjuhëve në të dy komunitetet duhet të identifikohen si dhe të përfshihen për të ndihmuar në komunikim. Propozimet për financim duhet të përfshijnë buxhete për përdorimin e përkthyesve dhe interpretuesve të rezultateve të projektit.

Sic është përmendur më parë, të dy GLV-të mund të ndihmojnë njëri tjetrin për të ofruar përkthime të mira të materialeve të përgatitura për turistët.

Ofruesit e shërbimeve dhe guidatorët mund të dëshirojnë të mësojnë gjuhë të tjera që do ti ndihmonin në komunikimin me turistët. GLV-të mund të ndihmojnë në organizimin e klasave të gjuhës Angleze e ndoshta edhe të kërkojnë ndonjë vullnetar ndërkombëtar që t'ju mësojë Anglishten (ose gjuhë të tjera të dëshiruara).

5 Identifikimi dhe mobilizimi i fondeve kombëtare si dhe burimeve të mbështetjes që mundësojnë zbatimin e aktiviteteve të specifikuar në MM.

6 Bashkëpunim për të zhvilluar dhe zbatuar projekte të përbashkëta dhe grante për të cuar më tej punën e Palëve në lidhje me MM.

Komente dhe udhëzime

GLV-të duhet të përgatisin një listë me fondet kryesore që kërkohen për të filluar aplikimin e MM dhe duhet të përqëndrojnë aktivitetet e rritjes së fondeve në mbështetje të këtij qëllimi. Shumica e çështjeve të këtij MM ka gjasa që të kërkojnë investime të mëtejshme ndaj duhet të përgatisin projekt-propozime për ti paraqitur tek burimet lokale të financimeve, tek autoritetet kombëtare si dhe donatorët ndërkombëtarë. Ndoshta është e nevojshme të realizohen trajnime në përgatitjen (shkrimin) e propozimeve dhe menaxhimin e projektit.

Masa të vecanta për bashkëpunimin ndërkufitar

Duhet bërë kujdes që shpërndarja e projekteve të përbashkëta të bëhet në mënyrë të ndershme ndërmjet të dy GLV-ve. Do të ishte e pa pranueshme që shumica e burimeve financiare të drejtoheshin tek njëri GLV, duke e lënë grupin tjetër pa burimet e duhura. Arritja e një balance perfekte do të jetë e pa mundur, por propozimet duhet të jenë mundësisht në formën e projekteve të përbashkëta, me një balance të drejtë në investime dhe aktivitete.

NENI 6. **AMENDIME, INTERPRETIME, SHTOJCA, DHE** **PERFUNDIME**

1. Ky MM do të jetë efektiv në datën e vendosur në krye të MM dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë prej pesë vjetësh. Secila Palë mund të propozojë amendime në cdo kohë; amendimet do të adoptohen nëse palët bien dakort bashkërisht me shkrim.
2. Çdo konflikt midis Palësh në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij MM do të zgjidhet miqësisht përmes konsultimit ose negociatave brenda shpirtit të bashkëpunimit.
3. Ky MM mund të anulohet mbi bazën e një marrëveshje të përbashkët të Palëve me shkrim e firmosur nga të dyja Palët.
4. Secila nga Palët mund të tërhiqet nga MM duke paraqitur njoftim me shkrim tek pala tjetër në një periudhë tre mujore.
5. Ky MM nuk është ekskluziv dhe nuk i kufizon aktivitetet e secilës Palë jashtë këtij programi të përbashkët bashkëpunimi, kur ato nuk kanë ndonjë ndikim negativ mbi kushtet e MM.
6. Bashkëpunimi nën këtë MM do të jetë subjekt i pranisë së fondeve dhe personelit të secilës Palë si dhe ligjeve dhe rregulloreve të secilit vend. Natyra dhe masa e fondeve për secilin projekt apo aktivitet të përbashkët do të vendoset nga Palët para fillimit të projekteve apo aktiviteteve.



Foto: © IUCN/Tomáš Pezold

Referenca të dobishme

Braack, L., Sandwith, T., Peddle, D dhe Thomas Petermann (2006). Marrja në Konsideratë e elementëve të Sigurisë në Planifikimin dhe Menaxhimin e Zonave Ndërkufitare të Konservuara. IUCN Gland, Switzerland dhe Cambridge.

Denman, R (2001) Udhëzues për zhvillimin e ekoturizmit me bazë-komuniteti. WWF International, Gland, Switzerland

Eagles, Paul F.J., McCool, Stephen F. dhe Haynes, Christopher D.A. (2002). Turizmi i qëndrueshëm në zonat e mbrojtura: udhëzues për planifikimin dhe menaxhimin. IUCN, Gland, Switzerland dhe Cambridge, UK

Hamilton, Lawrence dhe McMillan, Linda(eds) (2004).Udhëzues për Planifikimin dhe Menaxhimin e Zonave Malore të Mbrojtura. IUCN, Gland, Switzerland dhe Cambridge, UK.

IUCN (2006). Brezi i gjelbër i Europës: nga vizioni tek realiteti. IUCN, Gland, Switzerland dhe Cambridge, UK.

Sandwith, T., Shine, C., Hamilton, L. dhe Sheppard, D. (2001). Zonat e Mbrojtura Ndërkufitare për Paqe dhe Bashkëpunim. IUCN Gland, Switzerland dhe Cambridge, UK.

UNESCO (n.d) Rekomandime për Krijimin dhe Funksionimin e Rezervave Biosferike Ndërkufitare. UNESCO, Paris.

Vasiljevic, M. dhe Pezold, T. (eds.). (2011). Kalimi i kufijve për natyrën. Shembuj europianë të konservimit ndërkufitar. Zyra e Programit IUCN për Europën Jug-Lindore, Gland, Switzerland dhe Beograde, Serbi.

Banka Botërore (n.d) Rezervat ndërkufitare: Banka Botërore zbatimi i përfaqes së ekosistemit. World Bank, Washington DC.

IUCN. Komisioni Botëror për Faqen Elektronike të Zonave të Mbrojtura Ndërkufitare. www.tbpa.net



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND